



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 22/1 Prot.

Tiranë, më 06.01.2026

**V E N D I M**

**Nr. 4, Datë 06.01.2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 319, datë 12.12.2025, e paraqitur nga z. K.B kundër Shoqërisë Çagatay Logistics Albania sh.a, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Prej datës 21.11.2022, kam filluar punë pranë Shoqërisë Çagatay Logistics Albania në pozicionin si punonjës zyre dhe nuk kam marrë asnjëherë vërejtje apo masa disiplinore, përkundrazi vetëm vlerësime pozitive.

Në datë 31.10.2025, thirrem në zyrë nga Drejtori i shoqërisë z. G.S, i cili në prani të Menaxherit, z. Sh.H, shkurtimisht më njofton se do ishte dita e fundit e punës për shkak të shkurtimeve që po ndërmerre kompania, si dhe më vë në dispozicion një marrëveshje të nënshkruar prej tij, e cila do të rregullonte zgjidhjen e interesave, si pasojë e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës.

I shtangur nga kjo ndodhi nuk pranova të nënshkruaj marrëveshjen e ofruar. Për këtë qëllim i dërgoj sms edhe administratorit të shoqërisë z. Y.Ç.S, me datë 01.11.2025, por nuk kam marrë asnjë përgjigje për këtë fakt.

Me datë 04.11.2025, pasi u konsultova me një avokat, ju drejtova me një memo, z. G.S, duke i parashtruar të drejtat e mia ligjore që burojnë nga marrëdhënia e punës, si dhe zgjidhja e saj, e komunikuar prej tij në datë 31.10.2025, çka në vlerësimin tim, përbën dhe shkakun e diskriminimit. Në përgjigje të këtij komunikimi, z. S më përgjigjet me sms, duke më thënë që kontrata e punës është ende në fuqi.

*Me datë 21.11.2025, njoftohem me e-mail nga administratori i shoqërisë në lidhje me ndryshimin e orarit të punës (11.00-19.00), i cili prek mua dhe dy persona të tjerë.*

*Dy personat e tjerë “të afektuar” nga ky ndryshim i orarit të punës, janë vetëm për të “zhbërë” në pamje të parë sjelljen diskriminuese ndaj meje, pasi njëri prej tyre, z. A.S, prej kohësh nuk është rezident në Shqipëri, ndërsa tjetri, z. F.K banon brenda ambienteve të shoqërisë.*

*Gjithashtu nevoja operationale e shoqërisë për ndryshimin e këtij orari, të paktën sa i takon pozicionit tim të punës, i cili është i lidhur kryesisht me orarin zyrtar të institucioneve publike, e pamotivuar dhe arsyetuar, nuk përbën gjë tjetër veçse një fiktivitet për të vështirësuar vijimin e marrëdhënies së punës nga ana ime.*

*Gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time të punës, orari ka qenë 09.00-17.00, nga e hëna në të premte, plus të paktën dy ditë të shtuna për çdo muaj, me orar të reduktuar (09.00-13.00).*

*Në përgjigje të email-it mbi ndryshimin e orarit të punës, i drejtohem administratorit të shoqërisë për të më informuar në lidhje me:*

- i. Kohëzgjatjen e këtij ndryshimi të rëndësishëm të kushteve të punës, i cili ndikon direkt në angazhimet e mia jashtë pune, si dhe*
- ii. Organizimin e vajtjes dhe ardhjes nga puna si pasojë e këtij ndryshimi, duke konsideruar këtu se ambientet e punës janë në Vorë dhe vendbanimi im është në Tiranë.*

*Ky komunikim ka vijuar pa arritur në një zgjidhje të pretendimeve të mia sa i takojnë vijimit të kushteve dhe zakonisht mbi 3-vjeçar të marrëdhënieve të punës, çka nga përmbajtja e email-eve, dëshmohet edhe më shumë, sjellja diskriminuese nga ana e punëdhënësit, vetëm për shkak të pretendimeve të mia ligjore kundrejt veprimeve të tij.*

*Si konkluzion:*

- 1. Shkak i diskriminimit ka përbërë fakti i pretendimeve të mia ligjore dhe angazhimi i një avokati për përfaqësimin e interesave të mia, sa i takon zgjidhjes së marrëdhënies së punës apo të drejtave që burojnë prej saj.*
- 2. Sjellje diskriminuese janë veprimet të cilat ndryshojnë kushtet e marrëdhënies time 3-vjeçare të punës, direkt pas pretendimeve të mia ligjore, sa i takon orarit të ri dhe pamundësimin të transportit, duke afektuar angazhimet e mia jashtë pune si dhe duke shtuar kostot e transportit për në punë”.*

*Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin e marrëdhënieve të punës në kushtet e mëparshme.*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

*Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat*

*e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *““Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga subjekti ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 22.12.2025, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues, informacion dhe dokumentacion lidhur me situatën diskriminuese të pretenduar.

Subjekti ankues me email-in datë 29.12.2025, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, pasi marrëdhënia e punës është zgjidhur me marrëveshje me palën tjetër.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.*

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94<sup>1</sup>/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, z. K.B i cili me anë të kërkesës të përcjellë nëpërmjet e-mail-it datë 29.12.2025, është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa e paraqitur nga subjekti ankues në datën 29.12.2025, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës nr. 319, datë 12.12.2025, të paraqitur nga z. K.B kundër Shoqërisë Çagatay Logistics Albania sh.a, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 319, datë 12.12.2025, të z. K.B kundër Shoqërisë Çagatay Logistics Albania sh.a, për arsye se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>1</sup> *“Tërheqja e ankesës”*.